



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PEJË
OSNOVNI SUD PEĆ – BASIC COURT PEJA

P nr. 496/16

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË D.P. , gjyqtari Sejdi Blakaj me sekretaren juridike Gjyljeta Çorkadiu , në lëndën penale kundër të pandehurit S. Z sipas aktakuzës së PTH-së D.P. në Pejë PP/II. nr.1561/15 të dt.03.6.2016 për shkak të veprës penale: Rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par 8 të KPRK-së pas përfundimit të shqyrtimit fillestar , publik dhe me gojë, të mbajtur në praninë e të pandehurit S. Z dhe të prokurorit të shtetit me dt.10.8.2017 ka marrë dhe botërisht ka shpallë këtë :

A K T G J Y K I M

I pandehuri S. Z i lindur me dt..... në, ku edhe tani jeton, i biri i Z dhe nënës Sh e gjinisë V, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës , më parë i pa dënuar, gjendet në liri.

ËSHTË FAJTOR

Për arsye se:

Me dt. 10.8 .2015 , rreh orës 20:25 , në rrugën regjionale pikërisht në fshatin afër ish Drini petrol , i pandehuri nga pakujdesia ka shkelur ligjin mbi sigurinë e komunikacionit rrugor nga neni 54 pika 1 , në atë mënyrë që derisa po drejtonte automjetin e tij mercedes Benz , ngjyrë të zezë dhe me targa nga drejtimi Istog-Pejë , duke mos iu përshtatur shpejtësisë së lëvizjes , me pjesën e parë ballore e godet këmbësorin - të dëmtuarin L. O i cili ishte duke e trupuar rrugën në krahun e djathtë , me ç' rast nga goditja i dëmtuari pëson lëndime trupore dhe atë ndrydhje të indeve të buta të regjionit të djathtë ballor të kokës , plagë shqyese në ballë dhe në fytyrë , thyerje e kockës ballore dhe çatisë së orbitës së djathtë .

-me çka ka kryer veprë penale : rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par 8 të KPRK-së

Prandaj gjykata të pandehurit konform nenit 41, 42, 49, 50,51,52, dhe nenit 378 par 8 të KPRK-së. I SHQIPTON.

DËNIM TË KUSHTËZUAR

Në atë mënyrë që ia përcakton dënimin me burg në kohëzgjatje prej 3 muaj , e të cilin dënim i pandehuri fare nuk do ta vuaj nëse në afat prej 1 viti nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale .

Obligohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësorë të paguar shumë prej 15 euro kurse në emër të shpenzimeve të procedurës penale shumë prej 60 euro – 15 ditë pasi që aktgjykimi të merr formë e prerë I dëmtuari për realizimin eventual e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë me dt.06.6.2016 kundër të pandehurit S. Z ka ngritë aktakuzë PP/II. nr.1561/15, për vepre penale :rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par 8 të KPRK-së ,duke i propozuar gjykatës që pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësorë të pandehurin ta shpallë fajtorë , ta dënoj sipas ligjit dhe ta obligoj në pagimin e shpenzimeve procedurale .

Në shqyrtimin fillestarë i pandehuri – pasi që paraprakisht i është lexuar aktakuza , është njoftuar me të drejtat dhe detyrimet procedurale dhe pasojat e pranimi përkatësisht të mos pranimi të fajësisë- e ka pranuar fajësinë dhe ka manifestuar keqardhje për atë që i ka ndodhur i vjen shumë keq për këtë punë, sa do që ju betohem se këtu i dëmtuari ka dal shumë papritmas në rrugë ndërkohë që unë kam qenë duke drejtuar shumë ngadalë, dhe në spital menjëherë të dëmtuarin e ka dërguar djali im dhe menjëherë e gjithë familja ime kemi treguar interesim për gjendjen e tij shëndetësore me të dëmtuarin jemi pajtuar dhe tani kemi raporte shumë të mira.se është kështu mund të kuptoni edhe vet nga deklarata e të dëmtuarit të cilin e ka dhënë në prokurori me dt. 07.4.2016. Këtë pranim fajësie gjyqtari – pasi që paraprakisht e ka marrë pëlqimin e prokurorit të shtetit, i bindur se pranim fajësinë i pandehuri e ka bërë ashtu siç e parasheh ligji – vullnetarisht dhe pa u ndikuar nga askush dhe në asnjë mënyrë -e ka pranuar .

Meqenëse i pandehuri e pranoj fajësinë gjyqtari kaloj në marrjen e vendimit lidhur me llojin dhe lartësinë e masës ndëshkuese , me ç rast i pati parasysh të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese. Rrethanë rënduese në rastin konkret gjyqtari nuk ka gjetur , kurse nga ato lehtësuese ka çmuar : pranimin e singertë të fajësisë , pendimin e thellë për këtë gjë, qëndrimin korrekt në gjykatë, pa dënueshmërinë e mëparshme ,faktin se i pandehuri me familjen e të dëmtuarave janë pajtuar dhe tani kanë raporte shumë të mira, dhe kësaj gjyqtari mendon se edhe me një vendim si në dispozitivin e aktgjykimit ndaj të pandehurit do të arrihet qëllimi i ndëshkimit i paraparë me neni 41 të KPK-së .

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor është marrë konform nenit 450 të KPPRK-së.

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarit në kontestin e rregullt civil është marrë konform nenit 463 të KPPRK-së .

Nga sa u tha më lartë konform nenit 365 të KPPRK-së u vendos si më lartë.

Nga Gjykata Themelore në Pejë D.P. datë. 10.8.2017.

Sekretarja juridike
Gjyljeta Çorkadiu

Gjyqtari
Sejdi Blakaj

KËSHILLA JURIDIKE

Kundër këtij aktgjykimi lejohet
Ankesa në afat prej 15 ditësh nga
Dita e marrjes , Gjykatës të Apelit në Prishtinë
E përmes kësaj Gjykate .